AKR RPSDF SHAM SEMAFOR
Nr. 2810
Data 28-06-2013

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konusheveci nr. 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: ++381 38 500 400, Faks: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, web: www.pak-ks.org

Likuidimi i NSH SH.A.M SEMAFOR (PRZ 056)

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I mbylljes së procesit të likuidimit NSH SH.A.M SEMAFOR

2013 FEB 20 PM 2:48

Njësia e Likuidimeve nga AKP & Zyra Rajonale e Prizrenit
Versioni në Gjuhën Shqipe

Qershor 2013

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

DHOMËS SË POSAÇME

TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Datë :	Qershor 2013
Nr. rastit:	Të caktohet
Gjykatësi:	Të emërohet
Aplikuesi:	Autoriteti i Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Shoqata Auto Moto(SH.A.M) "SEMAFOR" Suharekë (në Likuidim).

RAPORTI PERFUNDIMTAR i Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "SH.A.M SEMAFOR" Suharekë (në Likuidim) dhe KËRKESA për mbylljen e rastit të likuidimit

---

PËRMBLEDHJE E KËRKESES

Autoriteti i Likuidimit (tani e tutje "AL") i Ndërmarrjes Shoqërore (tani e tutje "Ndërmarrja") SH.A.M "Semafor" në Suharekë i themeluar me datë 21 qershor 2012, me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pas kalimit të të gjitha fazave të procedimit të likuidimit që nga themelimi i tij ka përcaktuar se, NSh SH.A.M "Semafor" nga Suhareka nuk ka të evidentuar dhe nuk posedon në emër të saj me asnjë pronë apo aset, dhe si e tillë nuk ka të gjeneruar asnjë të hyrë nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit, dhe rrjedhimisht nuk disponon me fond të likuidimit përmes të cilit do t'i përmbushte detyrimet ndaj kreditorëve.

Prandaj, konform nenit 43 dhe nenit 44 paragrafit 2 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit i NSh SH.A.M "Semafor" përmes kësaj kërkese kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës që pas shqyrtimit të Raportit Përfundimtar të NSh SH.A.M "Semafor" të aprovon Raportin Përfundimtarë dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrjeje.

Për dhe në emër të Autoritetit të Likuidimit
të Ndërmarrjes Shoqërore "SH.A.M Semafor" Suharekë (në Likuidim)
Adrian Kelmendi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT TË NSH "SH.A.M SEMAFOR" SUHAREKË (në Likuidim)

Raporti Përfundimtar i AL për NSH "SH.A.M SEMAFOR" nga Suhareka përmban:

1. Përmbledhjen Ekzekutive 4
2. Historiku i shkurtër dhe statusi i NSH "SH.A.M SEMAFOR" nga Suhareka (në Likuidim)..... 8
3. Historiku i Procesit te Likuidimit 10
4. Vendimet mbi themelimin e Komisionit të Likuidimit dhe Autoritetit të Likuidimit 17
5. Publikimet e njoftimeve për fillimin e likuidimit në gazeta 24
6. Njoftimet formale Gjykatave dhe institucioneve relevante mbi fillimin e procesit te likuidimit 31
7. Shkresë konfirmuese nga NLB Bank për anulim të autorizimeve 49
8. Asetet 52
9. Pasqyra e Kërkesave dhe Vendimeve të Komisionit të Likuidimit 55
10. Njoftimi kreditorëve për mungesë të Fondeve 57
11. Shkresë konfirmuese nga Dhoma e Posaçme 69
12. Pasqyra Përfundimtare Financiare 71
13. Raporti i parave të imëta 74
14. Letër konfirmimi nga Administrata Tatimore e Kosovës 77
15. Letër konfirmimi nga Kuvendi Komunal lidhur me tatimin në Pronë 80

Shtojca 1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

NDËRMARRJA SHOQËRORE NSH ""SH.A.M SEMAFOR" në Suharekë"

Emërtimet e mëparshme dhe i tanishëm i ndërmarrjes:

Preduzece za Promet, Usluge I Obrazovanje Auto Moto "Semafor",d.o.o në 1991 (FI 2101/91)
Auto Moto Drustvo "Semafor" në 1992 ;
N.SH SH.A.M "Semafor" në vitin 2000;
Numri i Regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist (UNMIK) 80021755

Aktiviteti:	Shërbime dhe Edukim
Komuna:	Suharekë, Regjioni i Prizrenit

Me vendimin e Bordit të Drejtoreve të Agjencisë të datës 19.11.2010, ka filluar procedura e likuidimit ndaj Ndërmarrjes Shoqërore "SH.A.M SEMAFOR" nga Suhareka. Më 31 Dhjetor 2010 është bërë themelimi i Komisionit të Likuidimit për NSH "SH.A.M "Semafor", sipas autoritetit të dhënë me vendimin e datës 19.11.2010 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Me datën 21 Qershor 2012, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, bazuar në nenin 9 të Ligjit të AKP-së, dhe neni 6,12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka miratuar Vendimin për pushimin e mandatit të Komisionit paraprak të Likuidimit dhe themelimin e Autoritetit të Likuidimit. Në anën tjetër, me datën 10 Tetor 2012, është bërë edhe emërimi i anëtarëve nga personeli i AKP-së për të shërbyer në kuadër të Autoritetit të Likuidimit. Vendimet mbi emërimin e Komisionin paraprak të Likuidimit si dhe Autoritetin e Likuidimit janë paraqitur në Shtojcën 4 të Raportit Përfundimtarë.

Një histori e shkurtër e kronologjisë se procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "SH.A.M "Semafor" (në Likuidim) është paraqitur në Shtojcën 3 të Raportit Përfundimtarë. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-67 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 mbi Organizatat Tregtare si dhe nenit 43.3 (d), (e) dhe nenit 49 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve, Komisioni i Likuidimit në muajin Janar 2011, ka lëshuar njoftimet e nevojshme për fillimin e procesit të likuidimit në gazetat Koha Ditore, Kosova Sot, Vijesti dhe Blic me tirazh të konsiderueshëm në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Serbi. Kopjet e njoftimeve janë të paraqitura në Shtojcën 5 të Raportin Përfundimtarë.

Ndërsa njoftimet formale të gjykatave kompetente të vendit, institucioneve relevante për fillimin e procedurës së likuidimit përfshirë fletë-njoftimet si dhe kopjet e librit të pranimit nga PTK-ja si dëshmi se janë njoftuar institucionet, si dhe njoftimet e kreditorëve të njohur dhe potencial, janë të përmbledhura në Shtojcën 6.

Shkresa nga NLB Bank me anë të së cilës është njoftuar Komisioni i Likuidimit se janë anuluar (bllokuar) të gjitha autorizimet e nënshkruesve të mëparshëm në llogarinë e ndërmarrjes SH.A.M "Semafor", dhe se

bilanci në llogarinë e kësaj ndërmarrje është 0.00 € (zero). Kopja e shkresës së bankës është paraqitur në Shtojcën 7 të Raportit.

Komisioni paraprak i Likuidimit si dhe Autoriteti i Likuidimit bazuar në dokumentacionin nga institucionet relevante ka konstatuar se nuk ka pasur asete të kësaj NSH-ja për tu shitur. Për këtë qëllim AL posedon konfirmimin nga Kuvendi Komunal i Suharekës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës të prezantuara në Shtojcën 8.

Komisioni paraprak i Likuidimit para pushimit të mandatit të tij ka shqyrtuar 10 (dhjetë) kërkesa kreditore të cilat janë parashtruar ndaj NSH "SH.A.M "Semafor" në Suharekë. Lista përfundimtare e të gjitha kërkesave është pasqyruar në Shtojcën 9. Përderisa, njoftimet për mungesë të fondeve për përmbushjen e kërkesave kreditore të cilat janë dërguar të gjithë pretendueseve janë bashkangjitur në Shtojcën 10 të Raportit Përfundimtar.

AL i ka bashkangjitur Raportit Përfundimtar shkresën nga Dhoma e Posaçme e paraqitur si Shtojca 11, nëpërmjet të cilën konfirmohet se pranë Dhomës se Posaçme janë të regjistruara dy lëndë/ankesa (SCL-11-0048 dhe SCL-11-0049), në të cila paditës është Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Ankesat e regjistruara janë paraqitur ndaj njoftimit të datës 29/06/2011 të Komisionit paraprak të Likuidimit me anë të të cilit KL-ja ka njoftuar KEK-un dhe të gjithë pretenduesit e tjerë, se nuk ka fonde në dispozicion për përmbushjen e pretendimit, pasi që nuk ka të hyra të gjeneruara nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes Likuidimit të kësaj NSH-je.

Të hyrat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit janë zero euro (0 €), për faktin se ndërmarrja nuk ka asete të evidentuara në emrin e saj, ndërsa shpenzimet e likuidimit kanë arritur në vlerë prej 2,812.45 €, (të mbuluara nga Buxheti i Kosovës) që përfshijnë shpenzimet e njoftimeve për fillimin e likuidimit dhe shpenzimet e tjera operative. Llogaritja e Fondeve të Likuidimit, Pasqyra e Llogarisë së Likuidimit (kartela bankare e llogarisë së likuidimit të NSh SH.A.M "Semafor" në Bankën Qendrore të Kosovës e datës 03/06/2013) si dhe Raporti i Parave të imëta janë të përfshira në Shtojcën 12 dhe 13 të këtij raporti.

AL ka marrë konfirmimet nga Administrata Tatimore e Kosovës se NSH SH.A.M "Semafor" nuk është e regjistruar për TVSH, mirëpo ka obligime të tjera tatimore (për këtë çështje ATK edhe ka parashtruar kërkesa kreditore pranë Komisionit të Likuidimit brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procesin e likuidimit). Përderisa në anën tjetër, Komuna përkatëse përmes letrës së dërguar ka konfirmuar se ndërmarrja nuk ka obligime të tatimit në pronë, konfirmime këto të bashkangjitura në Shtojcën 14 dhe në Shtojcën 15 të Raportit Përfundimtar.

Në mbledhjen e mbajtur të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me datë 27 Qershor 2013, Bordi i Drejtoreve është informuar me përmbajtjen e Raportit Përfundimtar të AL për NSH "SH.A.M "Semafor" Suharekë.

Për dhe në emër të Autoritetit të Likuidimit
të Ndërmarrjes Shoqërore "SH.A.M Semafor" Suharekë (në Likuidim)

Adrian Kelmendi — Kryesues i Njësisë për Likuidime nga AKP - AKP Prishtinë, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit

Besnik Mazreku — Zyrtar për Likuidim - AKP ZR Prizren, Anëtar dhe Zyrtar i lëndës

Zuhra Dida — Zyrtare për Likuidim - AKP ZR Prizren, Anëtar (përfaqësues i komunitetit pakicë)

Shtojca 2
HISTORIKU I SHKURTËR DHE STATUSI I NSH "SH.A.M SEMAFOR", SUHAREKË

HISTORIKU I SHKURTËR DHE STATUSI I NSH "SH.A.M", Semaforë (në Likuidim)

Ndërmarrja është themeluar me Aktvendim të Sekretariatit të Punëve të Brendshme (SPB) të Komunës së Suharekës, nr. 28/87 datë 21.08.1987 si Shoqatë Auto – Moto "Semafor" me seli në Suharekë. Shoqata është e regjistruar në regjistrin e Organizatave Shoqërore dhe Shoqatave të Qytetarëve pranë SPB në Suharekë. Nga viti 1991 entiteti ka funksionuar si Ndërmarrje për Qarkullim, Shërbime dhe Edukim Auto Moto "Semafor" në Suharekë.

Si Auto Moto "Semafor", Ndërmarrja për Qarkullim, Shërbime dhe Edukim Auto Moto "Semafor", Suharekë është regjistruar me datë 04.09.1991 në Gjykatën Ekonomike në Gjakovë me numër Fi 2101/91. Përderisa regjistrimi i përkohshëm i ndërmarrjes si subjekt afarist në UNMIK është bërë me datë 04.06.2000 me numër regjistrimi 80021755 me emër SH.A.M Semafor në Suharekë.

Bazuar në deklaratat e drejtorit dhe dy instruktorëve të ndërmarrjes Auto Moto SHAM "Semafori" në Suharekë, datë 29.05.2009 dhe 30.08.2009 kjo ndërmarrje para vitit 1989 nuk ka pasur asnjë lidhshmëri pronësore apo bashkim me ndonjë ndërmarrje tjetër jashtë Kosovës dhe se gjatë viteve 1990 – 1999 kjo ndërmarrje nuk është transformuar në SHA.

Me datën 09/04/1990 Kuvendi Komunal i Suharekës dhe Shoqata Auto Moto "SEMAFOR" nga Suhareka, kanë lidhur kontratë mbi dhënien në shfrytëzim me kompensim të tokës ndërtimore dhe objektit afaristë të "Stacionit të vjetër të Veterinarisë" e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr. 1165 në vendim e quajtur "POJATA" në sipërfaqe prej 0.28.46 ha në Suharekë e shënuar në fletën poseduese nr.257 pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal të Suharekës. KK i Suharekës si bartës i të drejtës së pronësisë i ka dhënë për shfrytëzim Shoqatës Auto Moto "SEMAFOR" nga Suhareka pronën për kohën gjerë sa në atë tokë ndërtimore të fillojë realizimi i planit urbanistik dhe ndërtimi i objekteve të përcaktuara me planin urbanistik.

Drejtoria për Marrëdhënie Pronësore – Juridike e Komunës së Suharekës me datë 07.02.2007, ka marrë vendim për lejimin e ekzekutimit të vendimit të saj i bërë i plotfuqishëm me datë 26.04.2004, lidhur me lirimin e objektit të uzurpuar dhe të një pjese të ngastrës kadastrale 1165/1 dhe 1165/2 pronë e Komunës së Suharekës, në të cilën ndërmarrja ka ushtruar veprimtarinë e saj. Çështja lidhur me lirimin e objektit ka vazhduar edhe në Gjykatën Komunale të Suharekës e cila me aktgjykim ka vendosur në favor të Komunës duke urdhëruar SH.A.M "Semafor" të lirojë objektin. Ky aktgjykim i Gjykatës Komunale është vërtetuar me aktgjykim të instancës së dytë të datës 13.09.2005 dhe atë të datës 19.01.2007.

Rrjedhimisht, Agjencia përmes procedurave standarde për verifikimin e statusit të Ndërmarrjeve shoqërore të cilat bien në autorizimet administrative të Agjencisë, pas shqyrtimit të dokumentacionit relevante statusor me datë 11.01.2009, ka determinuar statusin e këtij personi juridik si Ndërmarrje Shoqërore e cila bie në mandatin dhe autorizimet e Agjencisë sipas nenit 5.1 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare te Privatizimit.

Shtojca 3
HISTORIKU I SHKURTËR I PROCESIT TË LIKUIDIMIT

NDËRMARRJA SHOQËRORE (NSH) "SH.A.M SEMAFOR"

Komuna:	Suharekë, Regjioni i Prizrenit
Data e fillimit të Likuidimit:	31 Dhjetor 2010
Data e afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave:	20 Mars 2011
Aktiviteti:	Shërbime dhe Edukim

3.1. Emërimet në Komisionin dhe Autoritetin e Likuidimit

3.1.1. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit mbi AKP-në (Nr. 03/L-067), Nenin 3 dhe 13.3 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/1, dhe Nenin 6.3 të Politikave Operacionale të AKP-së (vitit 2008), me datë 31 Dhjetor 2010, në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 19 Nëntor 2010, është bërë emërimi i Anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit për NSH "SH.A.M Semafor" (në Likuidim). Vendimi mbi emërimet është i bashkëlidhur Raportit përfundimtar në Shtojcën 4 .

Personat e emëruar si anëtarë të Komisionit të Likuidimit nga Agjencia me datë 31.12.2010 janë :

Venera Goxha, Udhëheqëse e Ekipit për Qeverisje Korporative -AKP ZR Prizren - Anëtar dhe Kryesues

Besnik Mazreku, Zyrtar për Zhvillim të Ndërmarrjeve-AKP ZR Prizren - Anëtar dhe Zyrtari i Lëndës

Zuhra Dida, Zyrtar për Zhvillim të Ndërmarrjeve-AKP ZR Prizren, - Anëtar dhe Sekretar

Fahridin Purova, Zyrtar Ligjor-AKP ZR Prizren - Anëtar dhe Zyrtar Ligjor

Paraprakisht me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar ("PCN") të datës 13.12.2010, si anëtar i emëruar ne Komisionin e Likuidimit nga PCN është emëruar Vanyo Ourouchev. Poashtu me vendimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar Maeve O'Connell është emëruar si zëvendësim (i përkohshëm) i anëtarit të emëruar nga PCN.

3.1.2. Si pasojë e ndryshimeve ligjore, rrjedhimisht me datën 21 Qershor 2012, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit të AKP-së, dhe nenit 6,12 dhe 13 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka miratuar vendimin për themelimin e Autoritetit të Likuidimit dhe njëkohësisht ka pushuar së funksionuari edhe mandati i Komisionit paraprak të Likuidimit. Përderisa me datën 05 Tetor 2012, janë emëruar anëtarët vijues për të shërbyer në kuadër të këtij Autoriteti të Likuidimit. Vendimi mbi emërimet është i bashkëlidhur Raportit përfundimtarë në Shtojcën 4 .

George Otterbien Udhëheqës i Ekipit Deloitte Kosova, Kryesues
(Deloitte Kosova – Kontraktor i angazhuar nga AKP-ja për ofrimin e shërbimeve profesionale në procesin e likuidimit)

Besnik Mazreku Zyrtar për Likuidim-AKP ZR Prizren, Anëtar dhe Zyrtar i lëndës

Udhëheqësi i Ekipit Deloitte Kosova (Ofruesi i Shërbimeve Profesionale- OSHP) në letrën e dërguar me datë 10 Shkurt 2013, ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që të largohet si anëtarë i Autoritetit të Likuidimit të NSh SH.A.M "SEMAFOR" në Suharekë pasi që kjo ndërmarrje nuk posedon asnjë aset (Neni 13 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së). Përderisa me datën 26 Shkurt 2013, Drejtori Menaxhues i AKP-së, ka miratuar ndryshimet në Autoritetin e Likuidimit si në vijim:

Është larguar:	George Otterbien – Udhëheqës i Ekipit Deloitte Kosova, Kryesues
Është emëruar:	Adrian Kelmendi – Kryesues i Njësisë së Likuidimeve nga AKP, Kryesues dhe, Zuhra Dida- Zyrtare për Likuidim - AKP ZR Prizren,

Letra e dërguar nga Udhëheqësi i Ekipit Deloitte Kosova (Ofruesi i Shërbimeve Profesionale- OSHP) është i bashkëlidhur Raportit Përfundimtarë në Shtojcën 4 .

3.1.3. Anëtarët e lartpërmendur të Komisionit dhe të AL kanë nënshkruar Deklaratat për Konflikt Interesi si në vijim:

Komisioni i Likuidimit:

Venera Goxha	i emëruar më 31/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011
Besnik Mazreku	i emëruar më 31/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011
Zuhra Dida	i emëruar më 31/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011
Fahridin Purova	i emëruar më 31/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011
Vanyo Ourouchev	i emëruar më 13/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011
Maeve O'Connell	zv. i emëruar më 13/12/2010	nënshkruar më 10/01/2011

Autoriteti i Likuidimit:

Adrian Kelmendi	i emëruar më 26/02/2013	nënshkruar më 28/02/2013
Besnik Mazreku	i emëruar më 05/10/2012	nënshkruar më 28/02/2013
Zuhra Dida	i emëruar më 26/02/2013	nënshkruar më 28/02/2013

3.1.4. Mbledhjet e Komisionit të Likuidimit.

3.1.4.1 Mbledhja e parë (I-rë) e mbajtur me datën 10.01.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Likuidimit

Të Pranishëm: Venera Goxha - Kryesuese; Besnik Mazreku (Zyrtar i Lëndës) – anëtar; Zuhra Dida (Sekretar)– anëtar, Fahridin Purova (zyrtar ligjor) anëtar; Vanyo Orouchev (EPCN) - anëtar;

Pikat Kryesore: Vërtetimi i emërimeve të Anëtarëve; Emërimi i Sekretarit; Vërtetimi se të anëtarët e kanë nënshkruar deklaratën konfliktit të interesit, KL-ja duhet të konfirmojë se NSH-ja nuk ka asete, njoftimi tek ARBK i fillimit të Likuidimit, kërkesa në ZQ për publikimin e fillimit të likuidimit në gazetat zyrtare. Anëtarët pajtohen të dërgohen njoftimet për Gjykatat, Bankën dhe të gjithë kreditorët/pretenduesit e njohur, të caktohet ofruesi i shërbimeve, të merren vulat e NSH-së dhe të bëhet kërkesa për hapje të llogarisë së likuidimit.

3.1.4.2 Mbledhja e dytë (II-të) e mbajtur me datën 15.04.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Likuidimit (përveç zyrtarit ligjor – Fahridin Purova)

Të Pranishëm: Venera Goxha - Kryesuese; Besnik Mazreku (Zyrtar i Lëndës) – anëtar; Zuhra Dida (Sekretar)– anëtar; Vanyo Orouchev (EPCN) - anëtar;

Munguan: Fahridin Purova (zyrtar ligjor) anëtar;

Pikat Kryesore: Miratimi i Procesverbalit paraprak nga anëtarët tjerë përveç atij në mungesë Fahridin Purova (zyrtar ligjor) anëtar; diskutimi dhe vlerësimi i detyrave dhe çështjeve; njoftimet në gazeta janë shpallur, njoftimet për gjykata, bankën, njoftimet për pretenduesit në databazën e ankesave, është bërë kërkesa për hapje të xhirollogarisë së likuidimit, kërkesa për para të imëta, kërkesa për të aprovuar pagesën një (1) mujore të ofruesit të shërbimeve (ish drejtorit të NSH-së), vulat e NSH-se janë dorëzuar nga ana e ish drejtorit të kësaj NSH-je. Deri në këtë kohë janë pranuar ankesat nga: Komuna e Suharekës, ATK (3 ankesa), Hidroregjioni, KEK-u, Ekoregjioni dhe 3 ankesa të punëtorëve. Është kërkuar që të analizohen ankesat dhe të përgatiten draft vendimet nga ana e zyrtarit të rasitit në bashkëpunim me zyrtarin ligjor.

3.1.4.3 Mbledhja e tretë (III-të) e mbajtur me datën 03.06.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Likuidimit

Të Pranishëm: Venera Goxha - Kryesuese; Besnik Mazreku (Zyrtar i Lëndës) – anëtar; Zuhra Dida (Sekretar)– anëtar; Fahridin Purova (zyrtar ligjor) – anëtar; Vanyo Orouchev (EPCN) - anëtar;

Pikat Kryesore: Miratimi i Procesverbalit paraprak nga anëtarët tjerë, konkludohet se NSH-ja nuk ka asete për shitje dhe nuk mund të gjenerojë të ardhura dhe si e tillë KL-ja nuk mund të vendosë që të paguaj ndonjë prej ankesave të pranuara. Janë përgatitur 10 draft njoftime.

3.1.4.4 Mbledhja e katërt (IV-të) e mbajtur me datën 28.06.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Likuidimit

Të Pranishëm: Venera Goxha - Kryesuese; Besnik Mazreku (Zyrtar i Lëndës) – anëtar; Zuhra Dida (Sekretar)– anëtar; Fahridin Purova (zyrtar ligjor) – anëtar; Vanyo Orouchev (EPCN) - anëtar;

Pikat Kryesore: Miratimi i Procesverbalit paraprak nga anëtarët tjerë, KL-ja pajtohet të dërgoj njoftimet tek 10 pretenduesit se nuk ka fonde, KL-ja do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmbyllje të procesit të likuidimit të kësaj NSh-je, zyrtari i rastit duhet të dërgoj një shkresë tek Agjencia Kadastrale e Kosovës që të konfirmoj se kjo NSh nuk ka asete në emër të saj.

3.1.4.5 Mbledhja e pestë (V-të) e mbajtur me datën 25.07.2011

Procesverbali: I nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit te Likuidimit

Të Pranishëm: Venera Goxha - Kryesuese; Besnik Mazreku (Zyrtar i Lëndës) – anëtar; Zuhra Dida (Sekretar)– anëtar; Fahridin Purova (zyrtar ligjor) – anëtar; Vanyo Orouchev (EPCN) - anëtar;

Pikat Kryesore: Miratimi i Procesverbalit paraprak nga anëtarët tjerë, zyrtari i ICO-së jep dorëheqje për shkak të përfundimit të mandatit dhe gjithashtu edhe Maeve O'Connell si personi zëvendësues i tij. Është përgatitur raporti për aktivitetet e KL-së të kësaj NSh-je në likuidim që nga emërimi i zyrtarëve të ICO-së, respektivisht të Vanyo Orouchev me datë 13.12.2010. Bazuar në informatat e disponueshme të NSh-së, e njëjta nuk ka asete të cilat do të mund të shiteshin përmes shitjes me likuidim. Është dërguar shkresa tek Agjencia Kadastrale e Kosovës për të konfirmuar se nuk ka asete të regjistruara në emër të NSh-së.

4. Asetet në fillim të Likuidimit të Ndërmarrjes

AL i NSH "SH.A.M SEMAFOR" (në likuidim) nuk ka identifikuar se kjo Ndërmarrje ka në pronësi asete të patundshme të cilat do të mund të realizonin të hyra gjatë procesit të likuidimit.

5. Njoftimet e lëshuara nga Komisioni i Likuidimit

Në përputhje me Nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-67 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 mbi Organizatat Tregtare si dhe Nenit 43.3 (d), (e) dhe Neni 49 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve, Komisioni i Likuidimit ka lëshuar Njoftimet vijuese:

5.1 Njoftimet për Fillimin e Likuidimit në gazeta:

13 Janar 2011, Njoftimi i parë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOHA DITORE
13 Janar 2011, Njoftimi i parë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOSOVA SOT
13 Janar 2011, Njoftimi i parë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Blic
13 Janar 2011, Njoftimi i parë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Vijesti
20 Janar 2011, Njoftimi i dytë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOHA DITORE
20 Janar 2011, Njoftimi i dytë në gj. Shqipe dhe gj. Angleze	në KOSOVA SOT
20 Janar 2011, Njoftimi i dytë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Blic
20 Janar 2011, Njoftimi i dytë në gj. Serbe dhe gj. Angleze	në Vijesti

Kopjet e njoftimeve të shpallura në gazetat e lartpërmendura janë të bashkëlidhura këtij raporti si Shtojca 6.

5.2. Njoftimi Zyrës për Regjistrimin e Bizneseve:

Më 06 Janar 2011, (gj. Shqipe, Serbe dhe Angleze). Kopja e librit të pranimit nga PTK i është bashkëlidhur raportit si Shtojca 6.

5.3. Njoftimet Kreditorëve të Njohur dhe Potencial, që përfshinë:

Korporata Energjetike e Kosovës,	më 28 Janar 2011
Administrata Tatimore e Kosovës, Zyra Regjionale e Prizrenit,	më 28 Janar 2011
Post-Telekomi i Kosovës,	më 28 Janar 2011
Komunalija (Ekoregjioni) Prizren	më 28 Janar 2011
MEF, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa,	më 28 Janar 2011
Hidroregjioni Jugor,	më 28 Janar 2011
KK i Suharekës – Suharekë	më 28 Janar 2011

Nadica Naspalic Shtërpcë, Kosovë	më 01 Mars 2011
Spira Krstic Rr. Brace Nedica b.b 14 000 4 Valjevo, Serbia	më 28 Janar 2011
Natasa Petrovic Rr. Zarka Zrenjanina, Br. 4 Kaluderica, Beograd, Serbia	më 28 Janar 2011

Kopjet e librit të pranimit nga PTK janë bashkëlidhur raportit si Shtojca 6.

5.4. Njoftimi Gjykatave

Kopjet e fletë-kthimeve të PTK-së tregojnë që Gjykatave vijuese i janë dërguar Njoftimet:

Gjykata Komunale në Suharekë	më 28 Janar 2011
Gjykata e Qarkut të Prizrenit	më 28 Janar 2011
Gjykata Ekonomike Prishtinës	më 28 Janar 2011
Gjykata Supreme e Kosovës	më 28 Janar 2011
Dhoma e veçantë e Gjykatës Supreme e Kosovës	më 28 Janar 2011

Kopja e njoftimit me fletë-kthimin nga PTK i është bashkëlidhur raportit si Shtojca 6.

5.5. Njoftimi për Bankën

NLB Bank – Dega në Prizren	më 11 Janar 2011

Kopja e librit të pranimit nga PTK i është bashkëlidhur raportit si Shtojca 6.

6. Pasqyra e Kërkesave

Emir i Kreditorit	Data e Pranimit	Shuma e Kërkesës	Njoftimi për mungesë të fondeve
Natasa Petrovic	09/10/2006	€ 9,099.98	29/06/2011
Spira Krstic	04/03/2011	€ 20,400.00	29/06/2011
ATK	10/02/2011	€ 4,969.58	29/06/2011
ATK	10/02/2011	€ 7,750.24	29/06/2011
ATK	10/02/2011	€ 472.85	29/06/2011
KK Suharekë	04/02/2011	€ 1,650.00	29/06/2011
Nadica Naspalic	01/04/2006	€ 20,000.00	29/06/2011
KEK	18/03/2011	€1,387.89	29/06/2011
RWC"Ekoregjioni"	14/03/2011	€ 208.68	29/06/2011
KRU Hidroregjioni Jugor	17/03/2011	€611.80	29/06/2011

Shtojca 4
VENDIMET MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT TË LIKUIDIMIT DHE AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci Nr. 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. ++ 381 38 500 400, Fax: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks, web: www.pak-ks.org

NJOFTIM

Për

Fillimin e Likuidimit
&
Caktimin e anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit

Emri i Ndërmarrjes: Shoqata Auto Motot "Semafor" – Fi 2101/91

Në bazë të nenit 9.1 të Ligjit 03/L-067 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 19 Nëntor 2010, Likuidimi i Ndërmarrjes së cekur më lart filion nga data e dhënies së këtij Njoftimi.

Sipas autorizimit që i është dhënë Zëvendës Drejtorëve Menaxhues të AKP-së, me vendimin e datës 19 Nëntor 2010, në përputhje me nenin 9.2 të Ligjit 03/L-067 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, personat në vijim janë emëruar si anëtarë të parë të Komisionit të Likuidimit duke filluar nga data e dhënies së këtij Njoftimi:

Venera Goxha – LTCG – Kryetar
Besnik Mazreku – ZZHN – Anëtar/ Zyrtar i lëndës
Zuhra Dida – ZZHN – Anëtar/Sekretar
Fahridin Purova – ZZHN - Ligjor – Anëtar

.....
Mrika Tahiri
Zëvendës Drejtor Menaxhues
Realizimi i Aseteve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

.....
Naim Avdiu
Zëvendës Drejtor Menaxhues
Qeverisja Korporative
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 31/12/2010

Njoftimi për fillimin e likuidimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Kërkesë për emërim të përbërjes së Autoritetit të Likuidimit

PËR:	Shkëlzen Liuka, Drejtor Menaxhues i AKP-së
PREJ:	Muharrem Arifi, Drejtor i DKL & Menaxher i Projektit
DATA:	05.10.2012
EMRI I NDËRMARRJES:	PRZ 056 SHAM Semafor Fi 2101/91 Emrat Alternativ: Auto Moto Drustvo "Semafor" në 1992 Preduzece za Promet, Usluge i Obrazovanje Auto Moto "Semafor",d.o.o në 1991

Pas miratimit të vendimit të Bordit të datës 21.08.2012 për të vazhduar me likuidimin e ndërmarrjes shoqërore (PRZ 056) SHAM Semafor, themelohet Autoriteti i Likuidimit në këtë përbërje:

EMRI	TITULLI	FUNKSIONI BRENDA AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT	DETAJET E KONTAKTIT
George Otterbein	Udhëheqës i Ekipit Deloitte Kosova	Kryesues	Tel: 049/780 - 701 email: geotterbein@deloittece.com
Besnik Mazreku	Zyrtar për Likuidim	Zyrtar i Rastit	Tel: 029/226-480 ext.105 email: besnik.mazreku@pak-ks.org

L03 Kërkesë për emërim të përbërjes së Autoritetit të Likuidimit
Faqe 1 nga 2

Sinqerisht,

DËRGUAR NGA :	
	Muharrem Arifi Drejtor i DKL & Menaxher i Projektit
DATA:	05.10.2012

APROVUAR NGA:	
	Shkëlzen Ljuka Drejtor Menaxhues i AKP-Së
DATA:	05.10.2012

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

10 Shkurt 2013

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Prishtinë, Republika e Kosovës

Për: Z. Muharrem Arifi, Drejtor i Departamentit të Likuidimit

I nderuari z. Arifi

OSHP-ja është emëruar si Autoritet i Likuidimit për dy NSH-të në vijim:

PRZ 056 Sham Semafor
MIT 005 AC Klina

Të dy këto NSH nuk kanë asete dhe për të qenë në përputhje me Politikat Operacionale të AKP-së dhe Udhëzuesin e Likuidimit, ne me mirësi kërkojmë që të na largoni ne si Autoritet i Likuidimit për këto dy NSH.

Gjithë të mirat,

George Otterbein
Kryesues

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Autoriteti i Likuidimit – Kërkesë për ndërrim të anëtarëve

PËR:	Shkelzen Uuka, Drejtor Menaxhues i AKP-së
PREI:	Muharrem Arifi, Drejtor i Departamentit për Koordinim të Likuidimit – Menaxher i Projektit
DATA:	25/02/2013
EMRI I NDËRMARRJES:	PRZ 056 SHAM Semafor Fi 2101/91 Emrat Alternativ: Auto Moto Drustvo "Semafor" në 1992 Preduzece za Promet, Usluge i Obrazovanje Auto Moto "Semafor",d.n.o në 1991

Ndryshimet në vijim janë të kërkuara për anëtarët e Autoritetit të Likuidimit:

EMRI	TITULLI	FUNKSIONI BRENDA AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT	DETAJET E KONTAKTIT
LARGO PERSONIN NË VIJIM			
George Otterbien	*Udhëheqës i Ekipit Deloitte Kosovo*	*Kryetar*	*Tel: 049/780-170 email: geotterbein@deloittece.com*
EMËRO PERSONIN NË VIJIM			
Adrian Kelmendi	*Kryesues i Njësisë së Likuidimeve nga AKP-ja*	*Kryetar*	*Tel: 044/851-523 Email: adrian.kelmendi@pak-ks.org*
ARSYEJA PËR NDRYSHIM			
Kërkesë nga Kontraktori (PSP) pasi që ndërmarrja është pa asketa.			

Gjithashtu emërohet si anëtar i AL-së si larteceku:

EMRI	TITULLI	FUNKSIONI BRENDA AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT	DETAJET E KONTAKTIT
Zuhra Dida	*Zyrtare per Likuidim*	*Anëtar pakicë*	*Tel: 044/126-887 email: zohra.dida@pak-ks.org*

LOBA Kërkesë për ndërrim të anëtarëve të AL Faqe 1 nga 2

Sinqerisht,

DËRGUAR NGA :	*Muharrem Arifi* Drejtor i Departamentit për Koordinim të Likuidimit
DATA:	*25/02/2013*

APROVUAR NGA:	
	Shkëlzen Liuka Drejtor Menaxhues
DATA:	26/02/2013

Shtojca 5
PUBLIKIMET E NJOFTIMEVE PËR LIKUIDIM NË GAZETA

NSH SHAM "SEMAFOR" – Suhareke PRZ056 (Fi 2101/91) në Likuidim

Njoftimi i parë 13/01/2011:

- Koha Ditore

[redacted]

NJOFTIM PËR LIKUIDIM
të
NSH. Shoqëria Auto Moto "Semafor" Suhareka

Emrit dikurës/Numri i regjistrimit dikurës e regjistrimit:

Auto Moto Drejtësi "Semafor" në 1992 ; Produkcioni Prometi, Ushtrimi i Drejtësisë Auto Moto "Semafor" ,ose në 1991 (Fi 2101/91)

Me bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenet 39.2 dhe 39.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi Organizimin Tregtar, dhe Nenet 43.3 (ë) dhe (ë) dhe Nenit 46 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarjeve dhe Pasurisë së tyre, JEPET NJOFTIMI se Likuidimi i Ndërmarjes së lartpërmendur do filluar prej 31 Dhjetor 2010, si bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit më 16 Nëntor 2010 e sipas Nenit 9.3 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (ë) dhe (ë) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, çdo person i cili besohet se ka ndonjë kërkesë ndaj Ndërmarjes – qoftë si kreditor apo si ndonjë palë tjetër ligjore – do ka të bëjë me Ndërmarjen, apo si pronar i Ndërmarjes, si dhe çdo palë tjetër – duhet t'u paraparaqitet Dëshmisë së Kërkesës për Likuidim deri më me datën 20 mars 2011. Kërkesë me datë më vonë ka mundësi që personat e tillë mos të kenë mundësi t'u marrin pjesë në procedurën e mundshme ligjore sipas Rregullores.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund t'i merrni drejtpërdrejtë nga zyrat e AKP-së në vënd apo prej:

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga "Rushkolekë" Nr. 9, 20000 Prishtinë
Kosovë/Kosovo
Telefon: +381 38 208 460

Formularët për kërkesa gjithashtu mund t'i merrni edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për detaje rreth të dënës së kërkesës, shih "Si të paraqitni një kërkesë".

Lista e sipërme dhe lista e paraqitjes së kërkesave do të njoftohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Rruga: "Rushkolekë" Nr. 9, 20000 Prishtinë dhe do njoftohet e hapur për shqyrtim publik vetëm deri pas 20 marsit 2011 (ose mënyrë tjetër se marsi i njoftuar publikisht) dëshmi nga palët e tretë, (Mundësia ekzistë ti paraqesësh me parë njoftimin e publikimit dëshmi me vonë e ndjejnë vetë, ju lutemi kërkojini nga ashtëtë e mësipërme për të marrë mënyra tjera të ligjshme.

Apeli do shqyrtohet vetëm sipërpërmënd nëse dëshmi A-s bëhet vetëm deri (jo apo më vonë se 20 shtator 2011) që do të publikohet, duke paraqitur edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare e Privatizimit (www.pak-ks.org).

[redacted]

NOTICE OF LIQUIDATION
of

SOE Shoqëria Auto Moto "Semafor", Suhareka

Alternative Former name and registration number:

Auto Moto Drejtësi "Semafor" in 1992 ;
Produkcioni Prometi, Ushtrimi i Drejtësisë Auto Moto "Semafor" ,ose in 1991 (Fi 2101/91)

Pursuant to Article 9 of Law No. 03/L-067 on the Privatization Agency of Kosovo, Sections 39.2 and 39.6 of UNMIK Regulation 2000/45 on Business Organizations, and Sections 43.3(ë) and (ë) and Section 46 of UNMIK Regulation 2000/48 on the Reorganization and Liquidation of Enterprises and their Assets, NOTICE IS HEREBY GIVEN that the Liquidation of the above enterprise will be commenced with effect from 31 December 2010 pursuant to a decision of the Board of the Privatization Agency of Kosovo dated 16 November 2010 under Article 9.3 of Law No. 03/L-067.

In accordance with Sections 43.3 (ë) and (ë) of UNMIK Regulation 2000/45, any person who believes he/she has a claim against the Enterprise – either as creditor or in respect of any assets related to or owned by the Enterprise or any other claim – should file a Liquidation Proof of Claim on or before 20 March 2011. Failure to do so may result in such persons being unable to participate in any proceeds of which Regulation.

The Liquidation Proof of Claim forms can be obtained from, and sent to, the following office of the Privatization Agency of Kosovo:

Privatization Agency of Kosovo
Street: "Rushkolekë" no. 9, 20000, Prishtinë
Tel: +381 38 208 460

The claim forms may also be obtained from the PAK web site at www.pak-ks.org. For details on how to file a claim see "How to register a claim".

A list of claims and a list of claimants will be made available at the Privatization Agency of Kosovo at St., "Rushkolekë" no. 9, 20000 Prishtinë and will be available for public inspection at this office after 20 March 2011 (or such later date as may publicly be announced) until further notice. If you have legitimate reasons as to why you are unable to travel to the above address, please contact the address to make other access arrangements.

The appeal will be allowed for claims by second list (only at a date in accordance with 20 September 2011) to be published, including on the Privatization Agency of Kosovo web site (www.pak-ks.org).

NSH SHAM "SEMAFOR" – Suharekë PRZ056 (FI 2101/91) në Likuidim

- Kosova Sot

NJOFTIM PËR LIKUIDIM
të
NSH Shoqëria Auto Motor "Semafor", Suharekë

Emri shoqërisë ishte e njohur edhe sipas emrit e regjistrimit:

Auto Motor Drustvo "Semafor" ka 1992 , Prodzanje za Promet, Uslugi i Obnovljivje Auto Motor "Semafor", A.d.o.k 1991 (FI 2101/91)

Me datë 6 maj 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/48 mbi Organizimin Tregtar, dhe Neni 43.3 (d) dhe (e) dhe Neni 49 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/5 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarjeve dhe Punës së tyre, JEPET NJOFTIMI se Likuidimi i Ndërmarjes u ka filluar me datë 31 Dhjetor 2010, si kërkesë e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 19 Nëntor 2010 sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/48, çdo person i cili besoi se ulëshi ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si krediton apo si çdo person tjetër ose çfardo lloj arsyeje ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si punës i Ndërmarrjes, si dhe çfardo kërkesë tjetër – duhet ti paraqesë Dëshmitë e Kërkesës për Likuidim deri më ose para 28 mars 2011. Nëse ouk bëhet kjo, atëherë ata mundet të mos jenë pjesëmarrës e bashkëpunëtorë apo kreditorë.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhënë duke ti drejtohemi ofiqës e AKP-së si vijë poshtë:

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: "Pashkatevë" Nr. 9, 10000 Prishtinë
Kosovë / Kosovo
Telefoni: +381 38 226 480

Formularët për kërkesë gjithashtu mund ti merrni edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Pë detaje ne di di dokumentet kërkesë, shih "Si di paraqitet një kërkesë".

Lista e emrave dhe listë e punëtorëve të kërkesave do ti vihet në dispozicion nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Rruga "Pashkatevë" Nr. 9, 10000 Prishtinë dhe do ti jetë e hapur për shqyrtim publik po nënë ajo ditë para 28 marsit 2011 (ose mbajë disa ditë pas ditës ë mund ti shpallë publikisht) duke ti njoftuar e vënë dënë. Nëse keni asnjë ti emërtuar pë punësimin e mëparshëm dëm ti rrëshqitë e kërkojnë, ju lutemi ti kontaktoni ti adresës e mëlëpëmë pë ti emërtuar mbyrsi fjëm ti qënë.

Asnjë do ti shoqëri pë shtë mbyrsëm mënë i mëpëmë ti mbyllëm ne datë (jo me herët se 01 shkurt 2011) ga do ti publikohet. Kërkë mbështë mënë më fiqëm e internetit ti Agjencisë Kosovare ti Privatizimit (www.pak-ks.org).

NOTICE OF LIQUIDATION
of
SOE Shoqëria Auto Motor "Semafor", Suharekë

Alternative Forms in which registration occurred:

Auto Motor Drustvo "Semafor" ka 1992 ;
Prodzanje za Promet, Uslugi i Obnovljivje Auto Motor "Semafor" A.d.o.k 1991 (FI 2101/91)

Pursuant to Article 9 of Law No. 03/L-067 on The Privatization Agency of Kosovo, Sections 39.3 and 39.6 of UNMIK Regulation 2001/48 on Business Organizations, and Sections 43.3(d) and (e) and Section 49 of UNMIK Regulation 2002/5 on the Reorganization and Liquidation of Enterprises and their Assets, NOTICE IS HEREBY GIVEN that the Liquidation of the above enterprise was commenced with effect from 31 December 2010 pursuant to a decision of the Board of the Privatization Agency of Kosovo dated 19 November 2010 under Article 9.1 of Law No. 03/L-067.

In accordance with Sections 43.3 (d) and (e) of UNMIK Regulation 2001/48, any person who believes he/she has a claim against the Enterprise - either as creditor or by reason of any matter related to it or as an owner of the Enterprise or any other claim - should file a Liquidation Proof of Claim on or before 28 March 2011. Failure to do so may result in such persons being unable to participate in any proceeds of sale of liquidation.

The Liquidation Proof of Claim forms can be obtained from, and must be filed with, the following office of the Privatization Agency of Kosovo:

Privatization Agency of Kosovo
Street: "Pashkatevë" no. 9, 10000, Prishtinë
Tel. +381 38 226 480

The claim forms may also be obtained from the PAK web site at www.pak-ks.org. For details on how to fill a claim see "How to register a claim."

A list of names and a list of claimants will be maintained at the Privatization Agency of Kosovo at St. "Pashkatevë" no. 9, 10000 Prishtinë and will be available for public inspection at the office after 28 March 2011 (or such later date as may publicly be announced) until further notice. If you have legitimate reasons as to why you are unable to travel to the above address, please contact the address to make other arrangements.

The assets will be offered for sale by sealed bid tender or a date (no earlier than 01 February 2011) to be advertised, including on the Privatization Agency of Kosovo web site (www.pak-ks.org).

NSH SHAM "SEMAFOR" – Suharekë PRZ056 (Fi 2101/91) në Likuidim

- BLIC

28 Blic — OGLASI — CETVRTAK 13. JANUAR 2011

KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
AGENSIONI I KOSOVËS I PRIVATIZIMIT
PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO

OBAVEŠTENJE O LIKVIDACIJI PREDUZEĆA

Za

DP Shoqëri Aksionare Mixto "Semafor", Suharekë

(Akronimi/Emri i plotë i Fi Njësisë)

Arsye Mbyllje Drejtori "Semafor" Sh.1992 | Prodajnice za Pneumatike, Ulitsa i Obnovenoto Arsye Mbyllje "Semafor" A.d.o.e. 1991 (FI.2101/91)

KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
AGENSIONI I KOSOVËS I PRIVATIZIMIT
PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO

NOTICE OF LIQUIDATION

of

DOE Shoqëri Aksionare Mixto "Semafor", Suharekë

(Acronym/Former name and registration number)

Arsye Mbyllje Drejtori "Semafor" Sh.1992 | Prodajnice za Pneumatike, Ulitsa i Obnovenoto Arsye Mbyllje "Semafor" A.d.o.e. 1991 (FI.2101/91)

- VIJESTI

34 Koha — marketing

OBAVEŠTENJE O LIKVIDACIJI PREDUZEĆA
ZA DP Shoqëri Aksionare Mixto "Semafor", Suharekë

NOTICE OF LIQUIDATION
of DOE Shoqëri Aksionare Mixto "Semafor", Suharekë

RAPORTI PERFUNDIMTAR PËR MBYLLJEN E PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË NSH "SH.A.M SEMAFOR"

NSH SHAM "SEMAFOR" – Suharekë PRZ056 (FI 2101/91) në Likuidim

Njoftimi i dytë 20/01/2011:

- Koha Ditore

AUDITIM PËR LIKUIDIM
të
NSH Shoqëria Auto Moto "Semafor", Suharekë

Emri dhe numërimi i regjistrimit dhe numri i regjistrimit:

Auto Moto Qendra "Semafor" in 1992; Fushatë e Prorës, Udhëqesi Obzovegija Auto Moto "Semafor" d.o.o. in 1991 (FI 2101/91)

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03L-067 Mbi Agencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/5 mbi Organizimin Tregtar, dhe Neni 43.3 (d) dhe (f) dhe Neni 49.1 Rregullores së UNMIK-ut 2002/5 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre, JEPET NJOFTIMI se Likuidimi i Ndërmarrjes si sipërpërmendur ka filluar prej 31 Dhjetor 2010, me bazë të vendimit të Bordit të Agencisë Kosovare të Privatizimit me 16 Nëntor 2010 dërguar Nr. 91 Ku ligji Nr. 03L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2002/5, çdo person i cili bëhet me çdo kërkesë ndaj Ndërmarrjes – edhe si kreditor apo në çfarë do cilësie tjetër, edhe si ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si pronar i Ndërmarrjes, si dhënës kërkesë tjetër – duhet t'i jepet njoftim Dëshmisë e Kërkesës për Likuidim deri më dje para 20 marsit, 2011. Nëse nuk bëhet kjo, mund të realizohet çë personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në procesin e shpërndarjes dhe procesit ligjor gjatë likuidimit.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhe duhet të dorëzohet në adresën e AKP-së si më poshtë:

Agencia Kosovare e Privatizimit
Rruga "Rushidi III" Nr. 9, 20000 Prishtinë
Kosovë, Kosovë
Telefoni: +381 38 235 450

Formularët për kërkesë gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën www.ask-kosova. Për detaje se si të plotësohet kërkesa, shiko "Si të paraqitet një kërkesë"

Lista e aseteve dhe lista e pretendimeve do të mbahet në Agencinë Kosovare të Privatizimit, në Rruga "Rushidi III" Nr. 9, 20000 Prishtinë dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik me datë 3 prej po 20 marsit 2011 (por nëse jo datë tjetër siç mund të shpallet publikisht) dhë ditë pune e mëvonshme. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësinë e vizitës dërgoni me postën e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni me adresën e mësipërme çdo të merrchini mënyra alternative.

Asnjë dokumentë apo shënime kërkesë nuk do t'u ofrohen dëshmitarëve dëshmi pas datës 20 shkurt 2011 (ose çdo datë tjetër siç do t'u bëjë e njohur) i Agencisë Kosovare të Privatizimit (www.ask-kosova.org).

NOTICE OF LIQUIDATION
of

SOE Shoqëria Auto Moto "Semafor", Suharekë

Name and Registration number:

Auto Moto Qendra "Semafor" in 1992;
Fushatë e Prorës, Udhëqesi Obzovegija Auto Moto "Semafor" d.o.o. in 1991 (FI 2101/91)

Pursuant to Article 6 of Law No. 03L-067 of The Privatization Agency of Kosovo, Sections 39.3 and 39.6 of UNMIK Regulation 2002/5 on Business Organization, and Sections 43.3 (d) and (f) and Section 49 of UNMIK Regulation 2002/5 on the Reorganization and Liquidation of Enterprises and their Assets, NOTICE IS HEREBY GIVEN that the Liquidation of the above enterprise was commenced with effect from 31 December 2010 pursuant to a decision of the Board of The Privatization Agency of Kosovo dated 16 November 2010 under Article 91 of Law No. 03L-067.

In accordance with Sections 43.3 (d) and (e) of UNMIK Regulation 2002/5, any person who has any claim against the Enterprise – either as creditor or in respect of any assets held in it or as an owner of the Enterprise or any other claim – should file a Liquidation Proof of Claim on or before 20 March 2011. Failure to do so may result in such persons being unable to participate in any proceed and of liquidation.

The Liquidation Proof of Claim forms can be obtained here, and must be filed with, the following address: The Privatization Agency of Kosovo

